

Pensionimi i profesionistëve të rinj



RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2022

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
ILDA METHASANI

Struktura e raportit:

1. Hyrja: Situata aktuale e punësimit në vendin tonë
2. Tregu i punës dhe papunësia
3. Politikat e punësimit në Shqipëri
 - Politikat e Qeverisë
 - Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
4. Përfundime dhe Rekomandime



Hyrje:

Viti 2022 është shpallur nga Bashkimi Evropian, si Viti Evropian i Rinisë, me qëllim për të vendosur në fokus rëndësinë që kanë të rinjtë me kontributin e tyre në të tashmen si dhe projeksionin për të ndërtuar një të ardhme më të shëndetshme dhe të sigurtë për të gjithë. Megjithatë, ngjarjet globale të viteve të fundit nuk kanë ndikuar pozitivisht në këtë drejtim. Zhvillime të tilla si: ndryshimet klimatike globale, situata e pandemisë dhe së fundmi lufta në Ukrainë, kanë krijuar një hapësirë për reflektim mbi gjendjen e të rinjve sot, në vendin tonë, në rajon dhe më gjerë.

Përgjatë vitit 2022, Tirana mbart titullin si "Kryeqyteti Evropian i të Rinjve". Pavarësisht titujve apo agjendave politike, në realitetin shqiptar, një ndër problematikat më të mëdha të rinisë lidhet me papunësinë.

Të rinjtë shqiptarë po përballen me sfida dhe vështirësi të cilat kushtëzojnë çdo ditë jetesën e tyre brenda vendit. Kjo konfirmohet jo vetëm nga vetë ata, por dhe nga të dhënat zyrtare të cilat tregojnë se të rinjtë gjithnjë e më shumë kërkojnë të largohen nga Shqipëria. Vendit tonë i mungojnë politikat për të adresuar çështjet më shqetësuese për rininë; duke filluar me punësimin dhe duke vazhduar me sigurimin e alternativave të tjera për angazhimin e tyre në tregun e punës.

Një anketë e vitit 2020 e profesorëve Gëdeshi dhe King, nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale me studentë, zbuloi se 79% e studentëve shqiptarë dëshirojnë të largohen nga vendi në raport me 65% në vitin 2018. Nga ana tjetër, 95% e atyre që studiojnë jashtë nuk dëshirojnë të kthehen.¹

Sipas sondazheve të Gallup², rreth 62% e shqiptarëve në vend dëshirojnë të largohen nga Shqipëria, një shifër alarmante kjo që kërkon një zgjidhje nga Qeveria Shqiptare dhe të gjitha instancat përgjegjëse. Ruajtja dhe rritja e kapitalit njerëzor në Shqipëri lidhet me problemet sistematike që prekin ekonominë dhe politikën shqiptare.

¹ Revista Monitor, aksesuar online: <https://www.monitor.al/ikja-e-te-rinive-fenomeni-i-largimit-eshte-me-i-larte-ne-shqiperi-se-kudo-tjeter-ne-europe/>

² Gallup, 2018. Aksesuar online: <https://news.gallup.com/poll/240938/balkan-neighbors-hopefuls-worlds-apart-migrants.aspx>

Tregu i punës dhe Papunësia

Papunësia e të rinjve përfshin të gjithë të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç, të cilët janë të papunë. Norma e papunësisë e të rinjve është përqindja e të papunëve të grupmoshës 15 deri në 24 vjeç, krahasuar me totalin e forcës së punës (të punësuar dhe të papunë) në atë grupmoshë. Megjithatë, duhet të kemi parasysh se një pjesë e madhe e personave midis këtyre moshave janë jashtë tregut të punës (shumë të rinj janë duke studiuar me kohë të plotë dhe në këtë mënyrë nuk janë në dispozicion për punë), e cila shpjegon pse shkalla e papunësisë tek të rinjtë është përgjithësisht më e lartë se normat e përgjithshme të papunësisë, ose nga ato të grupmoshave të tjera. Për këtë arsye, raporti i papunësisë së të rinjve është përdorur shpesh si përqindja e të rinjve të papunë në krahasim me popullsinë e përgjithshme të kësaj grupmoshe (jo vetëm aktive, por edhe të tilla joaktive si studentë).

Sipas INSTAT, në Shqipëri, në vitin 2021 llogaritej se kishte 2 milionë e 362 mijë individë në moshë për punë³. Të punësuar prej tyre ishin afro 1 milion e 248 mijë persona në të gjithë vendin, ndërsa të papunë ishin 162 mijë persona. 950 mijë shqiptarë rezultojnë sipas të dhënave të INSTAT si ekonomikisht jo aktivë, pra nuk figurojnë në asnjë bordero shtetërore apo private. Tregu i punës në Shqipëri vijon të jetë kaotik.


Në tremujorin e parë të vitit 2022, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri ishte 11,3%. Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç është 20,7%. Duke analizuar shkallën e papunësisë, sipas nivelit arsimor në vitin 2021, vihet re që shkalla e papunësisë është më e lartë për personat me arsim të mesëm, ndjekur nga ata me arsim 8 apo 9 vjeçar. Gjatë vitit 2021, 30,7% e popullsisë që i përkiste grupmoshës 15-64 vjeç ishte ekonomikisht jo-aktive.

Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan se janë nxënës/studentë ose në trajnim përbëjnë 72,2% të të rinjve ekonomikisht jo-aktivë. Ndër të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ekonomikisht jo-aktivë, 7,4% klasifikohen si të papunë të dekurajuar. Në popullsinë e moshës 30-64 vjeç, ky grup përbën 14,2% të popullsisë ekonomikisht jo-aktive të kësaj grup-moshe.

³Publikim i Euronews, aksesuar online:

<https://euronews.al/programs/shqiperi/unpublished/2022/06/11/tregu-i-punes-ne-shqiperi-pse-po-largohen-te-rinjte-l-unpublished/>.

Fig. 5 Struktura e popullsisë ekonomikisht jo-aktive sipas gjinisë dhe statusit



Burimi: INSTAT⁴ [Anketa Tremujore e Forcave të Punës, T1 - 2022 | Instat](#)

Cilat janë tanimë sfidat e të rinjve shqiptarë për përshtatjen e tyre në tregun e punës dhe ngritjen e një karriere të qëndrueshme dhe afatgjatë në profesionin që ata kanë zgjedhur të ushtrojnë?

Sipas ekspertëve të punësimit, gjatë një analize të zhvilluar nga platforma "Porta Vendor.al", rezulton që sfidat për rininë shqiptare janë:

- rritja e shkallës së punësimit;
- punësimi i qëndrueshëm, afatgjatë dhe me standarde
- rritja e zbatueshmërisë në praktikë, në mënyrë objektive dhe me shpejtësi e legjislacionit të miratuar për nxitjen e punësimit
- rritja e transparencës mbi financimet dhe iniciativat për nxitjen e punësimit
- zvogëlimi i burokracive
- rritja e aftësive ndërmjetësuese (punëdhënës-punëkërkuar) të institucioneve përgjegjëse për vendet e punës

⁴ [Anketa Tremujore e Forcave të Punës, T1 - 2022 | Instat](#)

Politikat e punësimit në Shqipëri

Instrumenti parësor institucional me të cilin qeveria mund të ndikojë në punësimin dhe integrimin e të rinjve lidhet me politikat aktive dhe të qëndrueshme të tregut të punës. Që nga viti 1999, në vendin tonë shohim zbatimin e programeve që kanë patur për qëllim nxitjen e punësimit për të luftuar nivelet e papunësisë dhe punën informale⁵. Në kohën e censusit të vitit 2011, **Shërbimi Kombëtar i Punësimit** realizoi katër programe kryesore të nxitjes së punësimit:

1. Programe për nxitjen e punësimit të punëkërkesve të papunë në vështirësi.
2. Programi për nxitjen e punësimit nëpërmjet trajnimit në detyrë.
3. Programi për nxitjen e punësimit të punëkërkesve të papunë të diplomuar nga universitete shqiptare dhe ndërkombëtare.
4. Programi për nxitjen e punësimit nëpërmjet trajnimit institucional

Në bashkëpunim me Bashkimin Evropian dhe Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), është publikuar dokumenti zyrtar "*Strategjia kombëtare për punësim dhe Aftësi 2014-2020*". Në këtë dokument vendoset theksi tek arsimi profesional, me qëllim përshtatjen e kërkesë-ofertës në tregun e punës, po ashtu dhe zbutjen e hendekut të papunësisë midis gjinive (Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë 2014).

Në vijim, u miratua "*Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 – 2022*", e cila në pjesën më të madhe të saj ishte një përsëritje e strategjisë së mëparshme. Sipas këtij dokumenti të miratuar, objektivi kryesor i Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 – 2022 është "*identifikimi dhe skicimi i politikave të duhura nxitëse të punësimit në vend dhe formimit profesional të forcës së punës, me qëllim që të hapen vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës*".

Modelet e ndjekura nga vendi ynë për punësimin

Në kuadër të përpjekjeve për integrimin në BE, hartimi dhe zhvillimi i politikave për punësim duhet të bëhet me synim harmonizimin dhe përputhjen me Udhëzimet e Strategjisë Europiane të Punësimit. Këshilli i Evropës ka përpunuar udhëzues të ndryshëm dhe rekomandime që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të politikave për punësimin, në

⁵ Besjan Lazja, Shtator 2020. Aksesuar online: <https://www.eurospeak.al/news/dritare-per-te-rinjte/20970-perspektiva-e-punesimit-te-te-rinje-ne-shqiperi-realitete-dhe-sfida/>

veçanti për grupet më të cenueshme, gratë dhe të rinjtë. Disa nga udhëzuesit ndërkombëtarë të pranuar nga vendi jonë janë:

1. **Konventa No. 122 (1964)** mbi politikat e punësimit të ILO është e ratifikuar prej Shqipërisë. Qeveritë e vendeve ratifikuese të kësaj Konvente janë të detyruara të formulojnë dhe të zbatojnë, në bashkëpunim me aktorët dhe partnerët socialë, politika aktive që të nxitin punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur me vullnet të lirë
2. **Karta Sociale Europiane e Rishikuar**, e cila është ratifikuar prej vendit tonë në vitin 2002, është një tjetër dokument shumë i rëndësishëm ndërkombëtar, në të cilin janë të përshkruara standardet që duhet të mbahen parasysh gjatë hartimit të politikave për punësim.
3. **Strategjia e Rishikuar e Kohezionit Social të Këshillit të Evropës**, e cila thekson se qasja për punësim për të gjithë dhe nxitja e një punësimi i denjë (punësim që respekton njeriun), janë elemente thelbësore për kohezionin social dhe se "*investimi në burimet njerëzore është një nga fushat më të rëndësishme të investimit për rritjen ekonomike për të ardhmen*".
4. **Agjenda Globale e Punësimit**, e hartuar nga ILO, është një dokument i rëndësishëm në të cilin janë të përpunuara indikatorët dhe standardet që duhet të merren parasysh prej qeverive të vendeve të ndryshme, anëtarë të ILO-së, për të mundësuar punën dinjitoze për të gjithë.

Politikat e Qeverisë ('13 - '22)

Me ardhjen në pushtet të qeverisë socialiste në vitin 2013, Ministri i Mirëqënies Sociale në atë periudhë, Erion Veliaj, nisi një tur inagurimesh nëpër Shqipëri të zyrave të reja të punës⁶. Me raste, në këto ceremoni inagurimesh merrte pjesë dhe kryeministri Edi Rama, i cili zotohej se qeveria e tij e kishte prioritet punësimin, ku një nga premtimet kryesore të fushatë elektorale ishte hapja e 300 mijë vendeve të reja të punës.

Sipas llogaritjeve të ekspertëve në 8 vite, qeveria nuk ka hapur më shumë se sa 20 mijë vende pune. Këtë e ka shpjeguar shumë thjeshtë dhe qartë, në një video divulgative, eksperti i ekonomisë Pano Soko.⁷

⁶ [Hapet zyra e punesimit online | ACP](#)

⁷ Gazeta Standard, 2020. Aksesuar online sipas linkut: <https://ëëë.facebook.com/ëatch/?v=719810301983855>

Sipas tij në vitin 2013, vendi kishte 510 mijë të punësuar që paguanin sigurimet në shtet. Të gjithë e kujtojnë se qeveria nisi një aksion të madh formalizimi dhe regjistrimi biznesesh që nuk figuronin në listat e tatimeve. Gjatë aksionit, skemës iu shtuan 142 mijë kontribues. Më vonë pati edhe dy aksione të tjera, për të cilat nuk u bënë publike kurrë shifrat zyrtare. Në fund të vitit 2019, Shqipëria numëronte 673 mijë të punësuar.

Sot, më shumë se 8 vite pas kësaj nisme, nuk ka asnjë informacion apo analizë mbi funksionalitetin e tyre. Madje zyra e punës që ndodhej në Tiranë në fillim të Rrugës së Kavajës, u largua që aty për t'i lënë vendin organeve të reja të vettingut dhe në motorrët e kërkimit nuk ka asnjë informacion se ku është zhvendosur ajo zyrë. Reforma e pretenduar në këtë shërbim duket se ka mbetur vetëm në letër apo deklarata për media. Shpesh ka pasur dyshime në opinionin publik se roli kryesor i këtyre zyrave është regjistrimi formal i punëkërkuesvë të papunë, për t'iu mundësuar përfitimin e përkrahjes ekonomike.

Në mandatin e parë të qeverisë u krijua “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe u miratua “Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020”. Në vitin 2019, me Vendim të Këshillit të Ministrave shkrihet Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe krijohet “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)”. Ky institucion i ri i sapokrijuar, përveç Zyrave Rajonale dhe Vendore të Punësimit dhe Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik ka në varësi të tij dhe Shkollat e Arsimit Profesional Publik. Pas shkrirjes së Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, AKPA kaloi në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Me ngritjen e Agjencisë duhet të themelohej dhe Këshilli Konsultativ për Punësimin, një organ këshillimor me përfaqësimin e organizatave të punëdhënësve, organizatave sindikale, si dhe institucioneve shtetërore.

Pavarësisht shkrirjes së një institucioni dhe themelimit të një institucioni tjetër me të njëjtat funksione, apo strategjive të njëpasnjëshme të hartuara dhe miratuara, duket se shumë pak gjëra kanë ndryshuar në **kontributin që ky institucion ka për uljen e nivelit të papunësisë në vend.**

Duke marrë shkas nga situata aktuale e punësimit apo ekonomisë në vend, natyrshëm lind pyetja nëse AKPA dhe të gjitha institucionet e tjera në varësi janë duke e kryer funksionin e tyre themelor të "ndërmjetësimit në tregun e punës midis punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe formimit profesional të punëkërkuësve të papunë për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës".

Çfarë është "Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)"?

AKPA është një shërbim publik, person juridik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për punësimin dhe zhvillimin e aftësive, e krijuar me qëllimin që të sigurojë përmbushjen e të drejtës së shtetasve për t'u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve.

Për të kuptuar më tepër dhe për të marrë përgjigje në lidhje me shqetësimin tonë nëse po bëhet mjaftueshëm për të përmirësuar situatën e punësimit dhe rritjen e kapacitieve të kapitalit njerëzor në Shqipëri, drejtuam disa pyetje për informacion Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Lidhur me politikat aktuale për të nxitur punësimin përgjigja theksonte se "Ministria e Financave nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive zbaton një gamë të gjerë programesh aktive të tregut të punës".

Duke pasur parasysh që papunësia tek të rinjtë apo fenomeni i shumë përhapur i largimit të të rinjve (brain drain) është një problem që prek jo vetëm vendin tonë por edhe rajonin, drejtuam kërkesë për informacion në lidhje me bashkëpunimet rajonale me institucionet e vendeve fqinje për tu përballur këto sfida. Në lidhje me këtë kërkesë, na informuan se ka disa platforma bashkëpunimi ndërmjet vendeve të rajonit siç është prezantimi i Skemës së Garancisë Rinore në vendet e Ballkanit Perëndimor, iniciativë e BE-së, mbështetje nga Regional Cooperation Council për krijimin e rrjetit të shërbimeve të punësimit në Ballkanin Perëndimor, si dhe marrëveshja e Open Ballkan.

Në këtë drejtim, një tjetër pyetje lidhej pikërisht me masat konkrete që po merren për të frenuar emigrimin masiv të forcës punëtore të kualifikuar drejt vendeve të BE-së. Në përgjigjen për masat që po

merren për të frenuar emigrimin masiv të forcës së punës, burimet nga Ministria e Financave nuk shprehën masa të qarta konkrete por na informuan se ekziston një gamë e gjerë programesh aktive të tregut të punës si dhe arsimit dhe formimit profesional.

Një tjetër çështje që adresuam lidhej me projeksionin e situatës së punësimit në vend në kuadër të aspiratave për anetaresim në Bashkimin Europian. Për këtë çështje, në mungesë të informacioneve të qarta, përgjigjja nga institucioni ishte se po bëhen të gjitha përpjekjet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së për kapitujt për të cilat japim kontribut.

Për më tepër, kërkesa për informacion drejtuar këtij institucioni vendoste theksin mbi:

- *Mënyrën se si matet dhe monitorohet rezultati i këtyre politikave/strategjive/veprimeve?*
- *Sa persona po aftësohen për vende pune?*
- *Sa individë janë punësuar përgjatë periudhës 2020-2022?*
- *Si asistohen personat që nga informimi, këshillimi, aplikimi e deri në sigurimin e punës dhe në vijim?*
- *Si funksionon koordinimi dhe bashkëpunimi mes AKPA-s dhe ministrive të linjës/ institucioneve partnere?*

Institucioni na udhëzonte që të konsultonim faqen zyrtare të web-it të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (https://www.financa.gov.al/punesimi-dhe-aftesimi_profesional/), ku publikohen raport-progreset vjetore të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, të cilat japin një pasqyrë të plotë mbi këto çështje, bazën ligjore dhe shërbimet që ofrohen.

Problematika e trajtuar është mjaft e gjerë, përfshirë aktivitetin e Agjencisë bazuar në materialet që mund të gjenden në faqen e tyre zyrtare. Në vijim do të trajtojmë shkurtimisht vetëm disa pika në lidhje me Agjencinë:

A. Eficenca në uljen e papunësisë

- Gjatë vitit 2021 u shpallën 24,965 vende të lira. Sipas aktiviteteve ekonomike, numri më i lartë i vendeve të lira është marrë nga industria përpunuese (48%), ndërtimi (10%) dhe akomodimi dhe shërbimi ushqimor (9%).⁸

⁸ Analiza Vjetore, 2021, AKPA. Aksesuar online:

<https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/Analiza-Vjetore-2021-AKPA.pdf>

- Sipas postimeve të fundit në llogarinë zyrtare të Ministres së Finacave dhe Ekonomisë deklarohet se vetëm brenda periudhës Janar-Qershor 2022, 4939 të rinj deri në 29 vjeç, të regjistruar në zyrat e punës janë punësuar.⁹
- Publikimi i Vendeve të Lira të Punës nga AKPA: Gjatë vitit 2021 janë shpallur 2152 kërkesa për publikim të vendeve të lira të punës së Administratës Publike.¹⁰
- Sipas INSTAT, në tremujorin e parë të vitit 2022, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 11,3 %. Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç është 20,7 %.¹¹

Siç mund të shihet, ka një hendek shumë të madh midis niveleve të papunësisë tek të rinjtë dhe përpjekjes për të sjellë përmirësim. Shpesh, shifrat që publikohen janë të qendëruara dhe jo koherente. Aktualisht, në faqen e Agjencisë (<https://www.puna.gov.al/>) janë rreth 4,500 oferta punësimi, një numër qartazi i vogël për të impaktuar situatën aktuale të papunësisë, pa u ndalur në detajet teknike të këtyre publikimeve.

B. Punësimi nëpërmjet Aftësimi

Pavarësisht se Agjencia ka krijuar disa strategji në raport me punësimin dhe aftësimin e të papunëve, ka një lidhje shumë të dobët, shpesh herë inekzistente mes këtyre dy palëve. Në strategjinë e Agjencise nuk gjendet ndonjë platformë, e cila të parashikojë një marrëveshje me universitetet dhe institucionet e tjera arsimore, private apo shtetërore për të rakorduar prurjet studentore me nevojat e tregut për staf të kualifikuar.

Një ndër pikat që Agjencia nuk ka marrë në konsideratë është nevoja për të kuptuar dhe analizuar se arsyet që po shtyjnë profesionistët e kualifikuar të largohen nga vendi. Një nga arsyet më të shpeshta se përse largohen punonjësit e kualifikuar lidhet me raportin në vlerë të pagave dhe kostove të jetesës, të cilat shpesh herë nuk arrijnë dot as të mbulojnë minimumin jetik. Agjencia nuk ka të përfshirë në vizionin dhe misionin e saj, zgjidhjen e problematikave të tregut të punës si: mosrespektimin e kodit të punës, sigurinë e ulët në mjedisin e punës, orët e zgjatura të papaguara. Këto problematika ndikojnë, që një pjesë e mirë e individëve të kualifikuar të largohen jashtë vendit, duke

⁹ Aksesuar online sipas linkut:

https://www.instagram.com/p/ChZrHZ1NE9t/?utm_source=ig_web_copy_link

¹⁰ Analiza Vjetore, 2021, AKPA.

¹¹ [Anketa Tremujore e Forcave të Punës, T1 - 2022 | Instat](#)

krijuar nevojën emergjente që këto problematika të trajtohen në mënyrë rigoroze nga ana e institucioneve.

C. Shpërndarja territoriale

Sipas Analizës vjetore për 2021 të AKPA-s¹², theksohet se Agjencia, gjatë viteve 2019-2021 ka nënshkruar 16 marrëveshje bashkëpunimi me 16 njësi të qeverisjes vendore. Në fund të vitit 2021, AKPA ka iniciuar hartimin e një metodologjie për mënyrën se si do të mund të realizohet shtrirja territoriale e zyrave të punësimit, në përputhje me nevojat e popullatës për përfitim të shërbimeve duke u mbështetur në principet e efikasitetit dhe fizibilitetit të resurseve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

Agjencia akoma nuk ka një zbatim apo vlerësim për sa i përket shtrirjes territoriale të veprimtarisë së saj. Kjo sjell që aftësimi profesional jo vetëm që zhvillohet në mënyrë joperiodike, por edhe të qendëruar. E thënë më thjeshtë, për shkak të shpërndarjes territoriale të qendrave të aftësimit, një pjesë e mirë e punëkërkuësve përjashtohen nga një program i fillë, pasi shtëpitë e tyre janë shumë larg këtyre qendrave. Skema kombëtare e punësimit nuk mbulon pothuajse asnjë nga zonat rurale në vend, pavarësisht se nevoja për punëtorë të kualifikuar në bujqësi, blegtori, menaxhim pyjesh, etj. është shumë jetike për automatizimin dhe rritjen e efikasitetit të këtyre njësive në të ardhmen. Mungesa e këtyre personave të kualifikuar në këto zona e bën me jetëgjatë prodhimin e fragmentuar familjar, duke e lënë të papërgatitur ndaj kërkesave të tregut. Nismat e ndërmarra janë sporadike, që bëhen pa një plan të mirëmenduar, në varësi të kushteve, nevojave, burimeve dhe kapaciteteve.

D. Strategjia e Komunikimit

Sipas Analizës vjetore për 2021 të AKPA-s, rezulton se strategjitë e komunikimit që përdoren janë nëpërmjet: Panairit të Punës, Publikimit të Vendeve të Lira të Punës, dhe Rastet e Suksesit.

Duke marrë parasysh problematikën e papunësisë në vend dhe të hendekut gjithmonë e më të ndjeshëm të kërkesës dhe ofertës për profesionistë, komunikimi i strategjisë me grupet e interesit duhet të jetë më tepër "agresiv". Në këtë drejtim, Agjencia nuk po bën informim të

¹²Analiza Vjetore, 2021, AKPA.

vazhdueshëm publik për programet e aftësimit, qendrat, kategoritë, përfitimet e tyre apo edhe më gjerë. Në website, numri i shpalljeve krahasuar qoftë me numrin e të papunëve apo dhe me shpalljet në faqe të tjera private, ku njerëzit mund të drejtohen për të kërkuar ose ofruar punë, është shume i ulët.

Nëse viziton platformat ekzistuese në rrjetet sociale të Agjencisë, rezulton që një numër i ulët ndjekësish ndërveprojnë virtualisht me AKPA-n dhe shërbimet, të cilat ajo ofron:

- Në llogarinë e saj në Instagram, Agjencia ka rreth 500 ndjekës;
- Në faqen e saj në Facebook ka 26 mijë ndjekës, ku pavarësisht numrit të ndjekësve, numri i pëlqimeve apo shikimeve të informacionit, videove promovuese, etj, është mesatarisht 150.



Përfundime:

- Një anketë e vitit 2020 e profesorëve Gëdeshi dhe King, nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale me studentë, zbuloi se 79% e studentëve shqiptarë dëshirojnë të largohen nga vendi në raport me 65% në vitin 2018.
- 95% e atyre që studiojnë jashtë nuk dëshirojnë të kthehen.
- Ruajtja dhe rritja e kapitalit njerëzor në Shqipëri lidhet me problemet sistematike që prekin ekonominë dhe politikën shqiptare.
- Sipas INSTAT, në Shqipëri, në vitin 2021 llogaritej se kishte 2 milionë e 362 mijë individë në moshë për punë, ku të punësuar prej tyre ishin afro 1 milion e 248 mijë persona në të gjithë vendin, **ndërsa të papunë ishin 162 mijë persona.**
- Në tremujorin e parë të vitit 2022, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 11,3 %.
- Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç është 20,7 %.
- Janë publikuar dy dokumente të njëpasnjëshme “Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi” përkatësisht 2014-2020 dhe 2019 – 2022. Në publikimin e dytë vihet re që në pjesën më të madhe të saj ishte një përsëritje e strategjisë së mëparshme.
- Me ardhjen në pushtet të qeverisë socialiste në vitin 2013, Qeveria kishte një nga premtimet kryesore të fushatë elektorale hapjen e 300 mijë vendeve të reja të punës. **Ndërkohë që sipas llogarive të ekspertëve, në 8 vite nuk ka hapur më shumë se sa 20 mijë vende të reja pune.**
- Në vitin 2019, me Vendim të Këshillit të Ministrave shkrihet Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe krijohet “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Pas shkrirjes së Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, AKPA kaloi në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Pavarësisht shkrirjes së një institucioni dhe themelimit të një institucioni tjetër më të njëjtat funksione, apo strategjive të njëpasnjëshme të haruara dhe miratuara, shumë pak gjëra kanë ndryshuar në **kontributin që ky institucion ka për uljen e nivelit të papunësisë në vend.**

Rekomandime:

1. Institucionet publike përkatëse duhet të jenë të vetëdijshme se punësimi produktiv i të rinjve nuk mund të arrihet përmes ndërhyrjeve sporadike por duhet të adresojnë më veprime të qëndrueshme dhe duke përfshirë aktivisht një gamë të gjerë aktorësh.
2. Institucionet publike dhe aktorët kryesorë përgjegjës për punësimin e të rinjve duhet të punojnë në mënyrë proaktive për një strategji integruese, e cila duhet të ketë misionin jo vetëm të shërbejë si një dokument zyrtar por edhe si një standart matës i progresit që po bëhet në krijimin e vendeve të reja të punës, uljen e papunësisë, aftësimin e të rinjve, etj.
3. Një koordinim dhe bashkëpunim më i mirë midis institucioneve qeveritare, si në nivel qendror ashtu dhe në atë lokal është i nevojshëm për t'u arritur.
4. Bazuar në bashkëpunimet dhe marrëveshjet e deritanishme, vëmendja e politika shtetërore për sektorin privat duhet të rritet, pasi ky sektor luan një rol të rëndësishëm për krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike dhe punësimin e të rinjve.

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD